

VENDIM
Nr.478, datë 12.7.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 10, pika 3 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 20 e vendimit nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“20. Masa e ndihmës ekonomike për prindërit e fëmijëve të lindur si:

- a) trinjakë është 3000 (tre mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë;
- b) katërnjakë është 4000 (katër mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë;
- c) pesënjakë është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj, për çdo fëmijë.

Kjo ndihmë ekonomike përfitohet deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, por jo më shumë se 18 vjeç.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, grupi 25, titulli 064, kap.1, artikulli 606 , “Transferta te familjet dhe individët”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha